

URDHËR

NR 608, DATË 04.09.2006

PËR

PRAKTIKAT PËR PAISJEN OSE RIPAISJEN E SHOQËRIVE ANONIME ME “AUTORIZIM” PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE PËR MARRJEN E “LEJES SË KONCESIONIT” PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E INSTALIMEVE BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

NË MBËSHTETJE TË PIKËS 4, TË NENIT 102 TË KUSHTETUTËS DHE NË ZBATIM TË PIKËS 1 DHE 2 TË [VENDIMIT NR. 555](#), DATË 03.08.2005 TË KËSHILLIT TE MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË [VENDIMIN NR. 30](#), DATE 28.01.2002 TË KËSHILLIT TE MINISTRAVE “PER KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TE SHOQERIVE QE DO TE NDERTOJNE DHE PERDORIN INSTALIME BREGDETARE PER TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE”, I NDRYSHUAR”, SI DHE TË PIKËS 1 DHE 2 TË [VENDIMIT NR. 214](#), DATË 29.03.2006 TË KËSHILLIT TE MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 30, DATE 28.01.2002 TË KËSHILLIT TE MINISTRAVE “PER KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARREDHENIEVE TE SHOQERIVE QE DO TE NDERTOJNE DHE PERDORIN INSTALIME BREGDETARE PER TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE”, I NDRYSHUAR”.

URDHËROJ:

1. SHOQËRITË QË KANË QËNË PAJISUR ME “AUTORIZIM” PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE PËR MARRJEN E “LEJES SË KONCESIONIT” PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E INSTALIMEVE BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE, KANË TË DREJTË TË PARAQESIN PRANË MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS KËRKESËN PËR RIPAISJE ME KËTË “AUTORIZIM”, DUKE E SHOQËRUAR ME DOKUMENTACION OSE PRAKTIKA TË TJERA, TË CILAT VËRTETOJNË FILLIMIN, NGA KËTO SHOQËRI, TË PROCEDURAVE PËR MARRJEN E “LEJES SË KONCESIONIT”.

2. NJËSIA E PËRPUNIMIT TË DOKUMENTACIONIT NË DREJTORINË E LIÇENCAVE DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMIN E PIKËS 2 TË V.K.M. NR. 555, DATË 03.08.2005, DHE MBI BAZËN E KËRKESËS DHE DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA SHOQËRITË, BËN TRAJTIMIN ADMINISTRATIV TË TYRE DHE PËRGATIT PRAKTIKËN, TË CILIN SË BASHKU ME EGZEMPLARIN E RI TË “AUTORIZIMIT”, PAS PROCEDURAVE MIRATUESE NË STRUKTURAT PËRKATËSE TË M.E.T.E., E PËRCJELL PËR MIRATIM PËRFUNDIMTAR. NUMËRI I “AUTORIZIMIT” TË RI TË JETË FRAKSION I NUMËRIT TË “AUTORIZIMIT”, QË KA PATUR MË PARË SHOQËRIA, E CILA KA APLIKUAR PËR RIPAISJE ME “AUTORIZIM”.

3. PËR BLLOQET QË AKTUALISHT REZULTOJNË TË LIRA, KOMISIONI I VLERËSIMIT TË KËRKESAVE QË PARAQITEN NGA SHOQËRITË, TË CILAT KËRKOJNË TË PAJISEN ME “LEJE KONCESIONI”, PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E INSTALIMEVE BREGDETARE PËR

TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE, DO TË KETË KËTË PËRBËRJE:

1. Z.GJERGJ BOJAXHI MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS. KRYETAR.
2. ZNJ. MIMOZA SIMIXHI MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS. ANËTAR.
3. Z.MARIN BIÇOKU MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT. ANËTAR.
4. Z. ANDI TOMA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT. ANËTAR.
5. ZJ. LILIANA ÇANO MINISTRIA E FINANCAVE. ANËTAR.
6. Z. ARTAN TAFI MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE. ANËTAR.
7. Z. SEIT KERTUSHA MINISTRIA E BRENDSHME. ANËTAR.
8. ZNJ. ALMA BAZE MINISTRIA E TURIZIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE. ANËTAR.
9. Z. BUJAR SEITI MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS. ANËTAR.
- 10.Z. ARTAN MERTIRI MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS. ANËTAR

1. FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KËRKESAVE, DO TË BËHET NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 30, DATE 28.01.2002 TË KESHILLIT TE MINISTRAVE “PER KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARREDHENIEVE TE SHOQERIVE QE DO TE NDERTOJNE DHE PERDORIN INSTALIME BREGDETARE PER TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE”, I NDRYSHUAR. SI DHE TË AKTEVE NËNLIGJORE TË NXJERRA NË MBËSHTETJE DHE PËR ZBATIM TË TIJ..

2. PËR ZBATIMIN E KËTIJ URDHRI NGARKOHET DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE.

KY URDHËR HYN NË FUQI MENJËHERË

**MINISTRI
GENC RULI**